



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Vlerësimi i Konkurrencës së tregut të energjisë përmes Indeksit të Herfindahl-Hirschman (HHI)

29 Dhjetor 2016



Përmbajtja:

1	Qëllimi i këtij Vendimi	Error! Bookmark not defined.
2	Matjet relevante evropiane	3
3	Matja e zgjedhur	4
4	Vlerësimi i konkurrencës në tregun me pakicë në Kosovë	5
	Referencat	7



1 Hyrje

ZRRE do të përcaktoj nëse duhet të vendos Obligimin e Shërbimit Publik (OSHP) mbi një apo më shumë furnizues për të kryer obligimin e Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU). Pjesë e përcaktimit është edhe vlerësimi i nivelit të konkurrencës në treg, që do ta vë FSHU-në në rrezik kur konkurrenca është joadekuate.

Në përputhje me rrethanat, ZRRE është duke aplikuar një metodologji të përshtatshme nga përvojat e vendeve të Evropës për të përcaktuar nivelin e konkurrencës. Prandaj, ky Vendim përcakton:

- Një pikëpamje të përvojës Evropiane;
- Matjen e duhur të konkurrencës dhe mënyrat e interpretimit të saj;
- Të gjeturat nga aplikimi i matjeve.

2 Matjet relevante evropiane

Ekzistojnë disa metoda të matjes së konkurrencës në tregjet e energjisë elektrike. Dy prej metodave më të përshtatshme të cilat përdorën tradicionalisht në masë të gjerë nga ekonomistët dhe autoritetet e konkurrencës janë CR₄ dhe HHI të cilat janë të përvetësuara në Raportet vjetore të ACER dhe CEER për tregjet e energjisë elektrike dhe gazit në Evropë (ACER dhe CEER, 2014).

CR₄ paraqet raportin e përqendrimit, i cili llogarit pjesëmarrjen e katër firmave më të mëdha në një treg ose industri, ndërsa HHI është Indeksi Herfindahl-Hirschman, fundit cili përdor informata mbi pjesëmarrjen e të gjitha firmave në treg apo në një industri të caktuar, gjë që nuk e bën CR₄, prandaj kjo mund të jetë edhe arsyeja e përdorimit më të gjerë të HHI për matjen e konkurrencës në industri brenda një tregu të caktuar.

Ndër indikatorët tjerë, mund të përfshihet edhe indeksi e tepricës së furnizimit (RSI), i llogaritur si:

$$RSI = \frac{\text{kapaciteti total} - \text{kapaciteti relevant i firmës}}{\text{kërkesa totale}}$$

Një dobësi e kësaj matje është vështirësia e gjetjes së të dhënave përkatëse për ta llogaritur atë. Kjo është një dobësi që mund të haset edhe tek shumë indikatorë të tjerë në dispozicion. Duke u nisur nga të gjitha vetitë e indikatorëve të ndryshëm të përshkruar më lartë, kemi vendosur që për qëllime të këtij hulumtimi do të përdorim HHI, të cilin e konsiderojmë si indikatorin më i zbatueshëm dhe mund të nxjerrë rezultate të besueshme dhe adekuate për qëllimin e matjes së konkurrencës në tregun e energjisë në Kosovë.

HHI për tregjet me pakicë të energjisë elektrike në Evropë është paraqitur në Tabelën 1. Vlerat 10.000 të HHI paraqesin një monopol të plotë, që mund të jetë reflektim i kompanive të energjisë elektrike të zotëruara tërësisht nga shteti, apo koncentrim i shërbimit tek një kompani e cila edhe



mund të mos jetë në pronësi të shtetit, por gjithsesi që ka monopol absolut në furnizimin me pakicë të energjisë elektrike. Sa u përket shteteve të paraqitura në tabelë, bazuar në HHI, shihet që tregu i energjisë elektrike i Rumanisë është i përqendruar më së paku.

Tregjet me pakicë të energjisë elektrike në shtetet e përzgjedhura evropiane	
Shteti	HHI
Austria	~1,800
Belgjika	3,000
Kroacia	4,516
Qipro	10,000
Estonia	6,869
Franca	>4,500
Greqia	>9,604
Hungaria	1,584
Irlanda	4,759
Italia	1,865
Latvia	8,196
Lituania	2,124
Malta	10,000
Polonia	2,099
Rumania	1,472
Slovenia	1,575
Spanja	2,240
Holanda	2,338
Mbretëria e Bashkuar	1,720

Burimi: Komisioni Evropian (2014)

3 Matja e zgjedhur

ZRRE ka përcaktuar se, për momentin, masa e zgjedhur për matje të konkurrencës do të jetë Indeksi i Herfindahl-Hirschman (HHI) e pjesëmarrjes në treg. Është një matje e njësive, ose madhësisë relative të firmave, brenda një tregu (pjesëmarrjes së tyre në treg). Poashtu, përdoret si një tregues i konkurrencës. Për një treg të caktuar, HHI llogaritet si:



$$HHI = \sum_{i=1}^N s_i^2$$

ku

$$s_i = \frac{Y_i}{\sum_{i=1}^N Y_i}$$

është pjesëmarrja në treg e furnizuesit i ,

Y_i është prodhimi (autputi) i firmës i në treg, dhe

N është numri i firmave në treg.

Vlerat e indeksit sillen nga:

$$\frac{1}{N} \leq HHI \leq 10,000$$

nëse pjesëmarrjet shprehen në përqindje. Në një treg me shumë firma, pra N është numër “i madh” (i firmave), shtrirja e indeksit mund të konsiderohet si:

$$0 < HHI \leq 10,000$$

Për thjeshtësi, vlerat më të vogla tregojnë industritë konkurruese, ndërsa vlerat më të mëdha tregojnë copëzimin në treg; $HHI = 10,000$ në rastin e veçantë të një monopoli, dhe $HHI \rightarrow 0$ (si $N \rightarrow \infty$) është rasti i konkurrencës së përkryer “atomistike”. Udhëzimet e publikuara nga Departamenti i SHBA-ve për Drejtësi ofrojnë parimin e mëposhtëm për vlerësim të konkurrencës:

- $HHI < 1500$ tregjet e papërqendruara
- $1500 \leq HHI \leq 2500$ tregjet mesatarisht të përqendruara
- $HHI > 2500$ tregjet e përqendruara në masë të madhe

4 Vlerësimi i konkurrencës në tregun me pakicë në Kosovë

ZRRE ka aplikuar testin HHI për nivelin e konkurrencës në tregun me pakicë. Për momentin janë tre [3] furnizues të licencuar për të furnizuar gjithë tregun me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë. Megjithatë, deri në datën e këtij Vendimi, dy nga këta furnizues nuk janë bërë plotësisht aktiv, prandaj KESCO ende ka 100% të pjesëmarrjes në treg. Si rezultat i kësaj, HHI rezulton në vlerën 10,000.

Edhe pse ky është një vlerësim historik i përqindjes në treg dhe ZRRE herë pas here do të rishikojë këtë llogaritje, me qëllim të përcaktimit të nevojës së vendosjes së OSHP-së, vlerësimi i konkurrencës



është se tregu është i përqendruar në masë të madhe dhe si rezultat jo-konkurrues. Prandaj ZRRE mund të vendosë Obligime të Shërbimit Publik për furnizim me pakicë të energjisë elektrike, në mënyrë që të mbrohen konsumatorët dhe tregu nga abuzimet e mundshme të pozitës monopoliste të furnizuesit aktual.



Referencat

US Department of Justice, 2010. *Horizontal Merger Guidelines*. [online] Available at: <
<https://www.justice.gov/atr/horizontal-merger-guidelines-08192010> > [Accessed 24 November 2016].

European Commission, 2014. *Progress towards completing the Internal Energy Market*. Commission Staff Working Document SWD(2014) 311 final. [online] Available at: <
https://ec.europa.eu/energy/sites/ener/files/documents/2014_iem_communication_annex2.pdf >
[Accessed 24 November 2016].

ACER and CEER, 2014. *Annual Report on the Results of Monitoring the Internal Electricity and Natural Gas Markets in 2014*. [online] Available at: <
http://www.acer.europa.eu/official_documents/acts_of_the_agency/publication/acer_market_monitoring_report_2015.pdf > [Accessed 24 November 2016].